

FJALA E DEPUTETES MILVA EKONOMI

E ENJTE 24 NËNTOR 2022

Në fakt, unë dua ta nis fjalën time me diçka që është e vërtetë për ne socialistët. Ne kemi një ëndërr ku duam ta shikojmë Shqipërinë, kemi një majë për Shqipërinë tonë dhe në këtë majë, që ne ëndërrojmë për Shqipërinë, pa dyshim, bëjnë pjesë 4 porte, 4 aeroporte, shumë zhvillime të tjera infrastrukturore, zhvillim më i mirë për familjet shqiptare dhe më shumë arsim për rininë shqiptare. Të gjitha këto, pa dyshim, lidhen edhe me fokusin tonë të projektet dhe të punët tona të përditshme, ndaj dhe ky projekt nuk vjen rastësisht.

Ky projekt është projekti i Durrësit, i cili e meriton këtë gjë, sepse, falë iniciativës private, zhvillimit që ka pasur vetë Bashkia e Durrësit, ka bërë të mundur që ëndrra të fillojë të ndërtohet. Rritja e sektorit të turizmit në Durrës ka qenë mbresëlënëse. Për shembull, strukturat akomoduese në 3 vjetët e fundit janë rritur me 233%. Përveç kësaj, një gjë shumë e rëndësishme, që ka ndodhur në portin e Durrësit, është numri i vizitorëve të huaj dhe shqiptarë, i cili ka qenë një numër në rritje. Shifrat tregojnë se gjatë kësaj periudhe, kur Bashkia e Durrësit me shumë kënaqësi grumbullon të dhëna, në Shqipëri kanë hyrë rreth 91 mjete lundruese në muajt janartetor dhe 5 mijë vizitorë të huaj e kanë vizituar Shqipërinë nga 335 mijë udhëtarë që kanë hyrë gjithsej në Durrës.

Sektori i peshkimit, një sektor tjetër ky i aktivitetit ekonomik që zhvillohet në Durrës, ka pësuar ndryshime dhe kjo jo vetëm falë ndërhyrjes së qeverisë shqiptare, por edhe falë ndihmës dhe mbështetjes që ka dhënë Bashkimi Europian për këtë sektor, duke bërë të mundur që 105 anije peshkimi që operojnë atje të kenë mundësi të gjenerojnë 3 milionë euro grante të dhëna nga Bashkimi Europian dhe ato të sjellin një nxitje ekonomike me 6,5 milionë euro. Nga ana tjetër, në Durrës ka ndodhur një ndryshim i madh mjedisor. Ju e dini që tashmë kemi një Eko-Park, i cili e ka kthyer zonën e Porto Romanos nga një zonë ku grumbulloheshin mbeturina dhe plehra, në një park ku mund të argëtohen fëmijë dhe ku mund të zhvillohen sporte.

Ne kemi një legjislacion të përmirësuar të investimeve strategjike, kemi një përmirësim të vazhdueshëm të strukturave tona të administratës publike, të cilat janë të afta të negociojnë kontrata dhe këtë punë e bëjnë në mënyrë të vazhdueshme dhe të përditësuar. Planifikimi është bërë shumë i kujdesshëm në të gjitha fazat dhe unë dua të ndalem në dy momente të cilat i kam jetuar vetë, kur ky projekt hartohet dhe

implementohej. Kur zoti Alabbar erdhi në Durrës përpara zgjedhjeve të vitit 2021, në portin e Durrësit ishin mbledhur shumë qytetarë durrsakë dhe mes të tjerave ne pamë edhe një video të zhvillimit të portit të ardhshëm të Durrësit.

Por nuk ishte vetëm kjo e rëndësishme, nuk ishte i rëndësishëm vetëm render-i që pamë, ishte i rëndësishëm komunikimi që ai pati me qytetarët e Durrësit, me Kryeministrin e Shqipërisë dhe me zonjën Balluku, e cila, si ministre e Infrastrukturës, e kishte ndjekur hap pas hapi deri në atë çast të gjithë projektin dhe, në fakt, sikurse edhe ajo tha, biznesmenë të tillë, si zoti Alabbar, janë “akullthyesit”, janë ata që sjellin një investim në një territor dhe pastaj ata shoqërohen nga investitorë të tjerë. Dhe ai iu drejtua popullit të Durrësit duke i thënë se është nga ata njerëz që ndërtojnë ëndrrën. “Unë nuk ndërtoj biznes, unë ndërtoj ëndrrën”, tha ai. Kjo ishte pjesa e parë e rëndësishme. Pjesa e dytë e rëndësishme lidhet me të gjitha fazat e planifikimit, të hartuara me shumë kujdes, të cilat ai personalisht i ka ndjekur nga afër.

Kur dy qeveritë tona u takuan në qershor, në Kosovë, pamë atje një projekt shumë të rëndësishëm, i cili kishte ardhur nga një studio holandeze “Royal Haskoning” për të bërë spostimin e portit aktual të Durrësit në portin e Porto Romanos. Ajo që ndodh ditë çdo ditë në Durrës është që porti nuk është pjesë e jetës së qytetarëve durrsakë, porti është një gjë e izoluar, që nuk i prek qytetarët durrsakë, ata jetojnë veç. Porti jeton veç dhe sjell me vete të gjitha ngarkesat që ka një port tregtar dhe nuk e bën një port të jetueshëm për qytetarët. Kur shikojmë fazat e ndërtimit të projektit, një gjë shumë e rëndësishme është fakti që njerëzit duhet ta prekin këtë investim strategjik, ndaj fillon pikërisht me ndërtimin e pjesës së peshkimit dhe markatës së peshkut, ku njerëzit e Durrësit, njerëzit që janë afër detit dhe ia dinë rëndësinë ekonomisë blu, ta shikojnë atë si një pjesë të gëzimit të jetës së tyre të përditshme.

Dhe unë besoj se me këto dimensione që ka projekti, ndërthuret shumë mirë me investimin strategjik, i cili ndjek hap pas hapi të gjitha ligjet shqiptare, të miratuara nga ky Kuvend, në të gjitha strukturat që punojnë për zbatimin e këtyre ligjeve dhe bën të prekshëm përfitimin nga investimet strategjike për njerëzit e zakonshëm. Gjëja tjetër shumë e rëndësishme, që unë dua të them për këtë projekt, është se ky është një projekt i studiuar me kujdes dhe ka marrë më shumë se tre vjet diskutime dhe nuk është e rastësishme që sot kemi një kontratë ku shteti merr pjesë me 33%. Ju keni parë shumë kontrata të tjera të investimeve strategjike, sepse në Shqipëri, falë këtij ligji, kemi bërë të mundur të kemi përmirësim në sektorë të tjerë, siç janë sektori i infrastrukturës dhe ai i bujqësisë, të cilët kanë dhënë mundësinë që investimet strategjike, që vijnë direkt në ndihmë të zhvillimit të qyteteve, të zhvillimit të ekonomisë, të vijnë në Kuvend për miratim.

Nga ana tjetër, është shumë e rëndësishme mënyra se si ne e shikojmë të lidhur qytetin me historinë e tij 3000-vjeçare dhe zhvillimin e këtij port të ri të marinave dhe jahteve. Qyteti i Durrësit nuk e ka pasur të lehtë në këta 3 vjet. Qyteti i Durrësit ka qenë nën ndikimin e fatkeqësive natyrore, tërmeti ishte një fatkeqësi natyrore që shembi shumë dhe nga strukturat tona të së kaluarës. Por, falë kërkesës, falë mbështetjes bujare dhe falë këmbënguljes së qeverisë shqiptare, donatorët qenë atje. Pak kohë më parë në Durrës u rikonstruktua një nga kullat e rëndësishme të kalasë dhe ajo u bë, sepse, ata që janë mbrojtësit e trashëgimisë kulturore botërore, erdhën në Shqipëri dhe me shumë angazhim u përpoqën ta rindërtonin kullën, e cila është atje e rindërtuar, e kthyer në identitet.

Atje po merr jetë dhe një koncept tjetër, ai i rijetëzimit të të gjithë pjesës së vjetër të Durrësit. Gjithashtu, ky projekt do të bëjë të mundur që porti të shkrihet me qytetin dhe të dalë në pah pikërisht kjo vlerë e rëndësishme historike që ka qyteti i Durrësit. Unë besoj se këto investime janë të lidhura, të shkruara më njëri-tjetrin dhe bëjnë të mundur që Shqipëria jonë të vijë në Ballkan, si një portë shumë e rëndësishme hyrëse e turizmit dhe kjo ndihmon në rritjen e reputacionit ballkanik rajonal apo dhe global të Shqipërisë. Kjo ndihmon, gjithashtu, që ekonomia jonë të performojë më mirë. Investimi, e dëgjuam shumë herë sot, kap shifrën e 2,1 miliardë eurove, ndërkohë e rëndësishme është edhe që kontributi në punësim do të jetë i lartë dhe do të shtohet çdo ditë.

Nga ana tjetër, edhe kontributi në GDP-në vjetore, që sjell ky projekt, është i kalkuluar, është gati 2% në vit. Kështu të gjitha këto japin një mundësi që dhe vetë performanca ekonomike e Shqipërisë të rritet. Por, mos harroni që bashkë me të gjithë këto struktura të rëndësishme hoteliere e prodhuese, ata që kanë qenë në Komisionin e Ekonomisë e dinë, zinxhiri ekonomik, që shkakton një investim i tillë, është shumë më i madh. Shumë sektorë të tjerë do të marrin pjesë në këtë nxitje të investimit strategjik. Dëgjuam, gjithashtu, se një nga pjesët më të rëndësishme janë shërbimet e reja që do të vijnë në Shqipëri, siç është shërbimi i mirëmbajtjes së marinave. Ky është një shërbim i ri, që, nga ana tjetër, kërkon që edhe rinia shqiptare të bëhet gati me dije për të pasur profesione të aplikueshme menjëherë në një investim strategjik, që po vjen në vend.

Prandaj, unë besoj fort që të gjithë ne, pavarësisht nga jemi, nga cila anë e sallës së parlamentit jemi ulur, majtas apo djathtas, ta shikojmë këtë si një investim, i cili i takon të ardhmes së Shqipërisë. Nuk është një investim që mbaron në kohën kur operon kjo qeveri që është sot; është një investim që u takon brezave; është një investim ku një kontratë e parë me shumë kujdes, bën të mundur që shteti shqiptar, duke pasur veton në kontratë, të ketë mundësinë ta kalojë nga qeverisja në qeverisje një projekt që është për të ardhmen e vendit dhe për të ardhmen e fëmijëve.

Unë besoj fort që durrsakët u entuziazmuan, ashtu si edhe ne, kur dëgjuam për projektin, por edhe që kishim afër një njeri që e donte Shqipërinë, sepse shqiptarët e duan Shqipërinë. Është shumë e rëndësishme kjo ndjenjë në një fazë të tillë biznesi. Ata që besojnë projektin, besojnë fort tek ideja dhe ëndrra e tyre dhe punojnë fort për të. Prandaj, unë ju ftoj ta votojmë këtë projekt, i cili na shërben të gjithëve; i shërben shumë ekonomisë së vendit dhe i shërben shumë edhe përparimit të Durrësit dhe shpalljes së tij si një pikë atraksioni në Ballkan. Faleminderit!